

ÇËSHTJA E
PERSONAVE TË PAGJETUR NË
KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE
NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM MBI:
ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË PAGJETUR NË
KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’ EVENTUALE
NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Shtator 2019

STUDIM MBI:
ÇËSH TJEN E PERSONAVE TË PAGJETUR NË
KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’ EVENTUALE
NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Shtator 2019

Përmbajtja

Shkurtesat	i
1) Hyrje	1
2) Historiku	2
3) Standardet Ndërkombëtare	6
4) Legjislacioni i Kosovës	8
5) Mekanizmat operues në Kosovë	9
6) Argumentet që Përshkruajnë Detyrimet Ligjore të Qeverisë së Serbisë ndaj Kosovës	14
6.1) Qeveria e Serbisë dhe institucionet përkatëse duhet të respektojnë dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare lidhur me Personat e Pagjetur	14
6.3) Kosova dhe Serbia duhet të bashkëpunojnë për të zbuluar fatin e personave të pagjetur	19
6.4) Bashkëpunimi i Qeverisë së Serbisë dhe institucioneve përkatëse duhet të tregojë se Serbia po kontribuon për paqen dhe marrëdhëniet paqësore midis Kosovës dhe Serbisë.....	22
7) Përfundimet	26
8) Rekomandimet	27

Shkurtesat

FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare
GPZhDP	Grupi Punues për Zhdukjen e Detyruar ose të Pavullnetshme
GJNP	Gjykata Ndërkombëtare Penale
GjPNJ	Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjPNJ)
KKIV	Komisioni i Kthimit dhe Identifikimit të Viktimave
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KNPP	Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur
KRIV	Komisioni i Rimëkëmbjes dhe Identifikimit të Viktimave
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NjHKL	Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës
NjPP	Njësia e Personave të Pagjetur
NjQHP	Njësia Qendrore e Hetimeve Penale
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
ZPKL	Zyra e Prokurorit të Krimeve të Luftës
ZPZHF	Zyra për Persona të Zhdukur dhe Forenzikë
DML	Departamenti i Mjekësisë Ligjore

1) Hyrje

1. Sipas deklaratës së fundit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) “nga 6,057 persona të raportuar në KNKK si të zhdukur në lidhje me konfliktin e armatosur në Kosovë dhe pasojat e tij, 1,647 janë ende të pagjetur”.¹
2. Numri i identifikimeve të personave të zhdukur është relativisht i vogël dhe shkalla e gjetjes, rikthimit dhe identifikimit të tyre është në rënie. Ky fakt u theksua edhe nga kryetari i grupit punues të KNKK-së z. Fabien Bourdier, duke vënë në dukje vetëm shtatë raste të zgjidhura në vitin 2018.² Si rezultat, familjet e personave të pagjetur për dekada jetojnë me humbjen e pazgjidhur të të dashurve të tyre. Prandaj, ata nuk mund të kalonin nëpër procesin e pikëllimit njerëzor. Shkalla e rënies së gjetjes së personave të zhdukur është brengë e veçantë; prandaj, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kosova duhet të trajtojë çështjen e të pagjeturve dhe ta sjellë në agjendën e dialogut. Rëndësia e personave të pagjetur në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është theksuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, i cili deklaroi se çështja e personave të pagjetur do të jetë një nga çështjet e para që do të diskutohet në raundin e ardhshëm të dialogut.³
3. Sipas raportit të Grupit Punues për Zhdukjen e Detyruar ose të Pavullnetshme (GPZhDP), një pengesë e madhe për përcaktimin e fatit dhe vendndodhjes së personave të pagjetur në Kosovë është mungesa e informacionit të saktë për vendndodhjet e varrezave të pazbuluara. Besohet se autoritetet serbe posedojnë më shumë informacione sesa që kanë përfshirë në dokumentet tashmë të dorëzuara. Sipas këtij raporti, ekziston një perceptim i përbashkët në Kosovë se

¹ ICRC (2018), ‘Njëzet vjet pas, 1,647 njerëz ende të zhdukur në Kosovë’. Në dispozicion në: <https://www.icrc.org/en/document/twenty-years-1647-people-still-missing-kosovo> [Qasur më: 10 gusht, 2019].

² Po aty.

³ Thaçi, H., 2018. *RTV21 Intervistë me Hashim Thaçin* [Intervistë] (28 12 2018).

ushtria serbe ka të dhëna të plota për vendet e varrezave, por nuk ka hapur plotësisht arkivat e saj.⁴

4. Ky studim përshkruan arsyet dhe argumentet që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të përfshijë në agjendë çështjen e personave të pagjetur gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999 dhe pasojat e tij. Ky studim ofron informacion në lidhje me historikun e konfliktit të armatosur në Kosovë, kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare, si dhe mekanizmat operues në Kosovë. Në fund, ky studim ofron katër argumente për adresim të çështjes së personave të pagjetur në dialog:

- Qeveria e Serbisë dhe institucionet përkatëse duhet të respektojnë dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare në lidhje me Personat e Pagjetur;
- Familjet e personave të pagjetur duhet të kenë të drejtën për të ditur lidhur me fatin e të afërmeve të tyre që nuk u gjetën si pasojë e konfliktit të armatosur;
- Kosova dhe Serbia duhet të bashkëpunojnë për zbulimin e fatit të personave të pagjetur;
- Bashkëpunimi i Qeverisë së Serbisë dhe institucioneve të saj përkatëse duhet të tregojë se Serbia po kontribuon për paqen dhe marrëdhëniet paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

2) Historiku

5. Konflikti i armatosur në Kosovë eskaloi në shkurt të vitit 1998 dhe zgjati deri në qershor të vitit 1999. Çlirimi i Kosovës nga forcat serbe u arrit me përpjekjet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe mbështetjes ajrore të Organizatës së

⁴ Këshilli i të Drejtave të Njeriut & Grupi Punues mbi Zhdukjet e Detyrueshme dhe Jo-vullnetare, (2015), 'Promovimi dhe mbrojtja e të gjitha të drejtave të njeriut, civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë të drejtën për zhvillim'. Në dispozicion në: https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session30/Documents/A-HRC-30-38-Add1_en.pdf [Qasur më: 12 gusht 2019].

Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Ndërhyrja e NATO-s ishte e pashmangshme pasi që fatkeqësia humanitare dhe spastrimi etnik po arrinin kulmin, pasi gati gjysma e popullsisë u dëbua nga Kosova, dhe rreth 300,000 u zhvendosën brenda vendit⁵ në male dhe lokalitete tjera. 13,517 njerëz, kryesisht civilë, por edhe pjesëtarë të forcave të armatosura, u vranë ose u zhdukën gjatë periudhës së konfliktit të armatosur.⁶

6. Gjatë këtij konflikti të armatosur, civilët pësuan më së shumti si pasojë e dëbimeve nga shtëpitë dhe nga vendi, vrasjeve, rrëmbimeve, arrestimeve, zjarrvënies etj. Gjatë asaj kohe një pjesë e viktimave të luftës u zhdukën dhe që atëherë vendndodhja e tyre ende nuk dihet. Njerëzit u arrestuan në mënyra të ndryshme, dhe në rrethana të panjohura.⁷ Përveç kësaj, civilët u arrestuan në shtëpitë e tyre ose në ato të fqinjëve të tyre, ndërsa disa prej tyre u mbajtën në rrugë. Për më tepër, në shumicën e rasteve njerëzit u arrestuan përderisa policia hyri në fshatrat e tyre dhe shpesh ata vranë çdo person që takonin. Familjet ishin të ndara; në të vërtetë burrat ishin të ndarë nga gratë. Fatkeqësisht, viktimat të cilët u arrestuan ose u vranë, në shumicën e rasteve u zhdukën pa gjurmë.
7. Njerëzit që nuk u gjetën gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999, ose u vranë ose u morën gjallë dhe u vranë në vende të ndryshme nga forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe.
8. Para tërheqjes së forcave të ish-Republikës së Jugosllavisë në qershor të vitit 1999 me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, është vërejtur se trupat e civilëve të vrarëve janë zhvarrosur nga varret e tyre për t'u transportuar në Serbi

⁵ Suhrke, A., Barutciski, M., Sandison, P. & Garlock, R., (2000), 'Krizat e refugjatëve në Kosovë - Një vlerësim i pavarur i gatishmërisë dhe reagimit emergjent të UNHCR-së'. Në dispozicion në: <https://www.unhcr.org/excom/standcom/3ae68d19c/kosovo-refugee-crisis-independent-evaluation-unhcrs-emergency-preparedness.html> [Qasur më: 13 gusht 2019].

⁶ Balkans Insight (2014), 'Lista e viktimave të luftës në Kosovë'. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2014/12/10/kosovo-war-victims-list-published/> [Qasur më: 12 gusht 2019].

⁷ Brovina, Q. & Berisha, B. (2006), 'MONOGRAFIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT'. Në dispozicion në: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=953629 [Qasur më: 13 gusht 2019].

dhe janë varrosur në varreza të panjohura.⁸ Qëllimi kryesor i transportimit ishte të humbiste gjurmët e krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur.

9. “Mbetjet njerëzore nga konflikti i Kosovës u dogjën në dy raste, më 16 dhe 24 maj të vitit 1999 në fabrikën e aluminit Maçkatica (pranë Surdulicës) në Serbinë jugore”.⁹ Fondi për të Drejtën Humanitare me bazë në Beograd shpërndau informacione të bazuara në burime të shumta të pavarura. Për më tepër, në prill të vitit 2005, Vladimir Vukçević i cili ishte Prokuror i Krimeve të Luftës në Serbi, vizitoi fabrikën Maçkatica bashkë me gjykatësin hetues të Gjykatës së Qarkut në Vranjë dhe një ekip ekspertësh mjeko-ligjorë. Në fabrikën Maçkatica ata ekzaminuan të gjitha furrat e shpërthimit dhe të gjitha vendet që përmbajnë mbetje minierash. Rezultatet e hetimit të udhëhequr nga Kryeprokurori i Krimeve të Luftës në lidhje me akuzat e ngritura nga Fondi për të Drejtën Humanitare ende nuk janë bërë publike.¹⁰

10. Fondi për të Drejtën Humanitare më 28 tetor të vitit 2014, ka përpiluar dhe ka parashtruar një ankesë penale në Zyrën e Prokurorit të Krimeve të Luftës (ZPKL) kundër pesë personave për shkak të dyshimit të arsyeshëm se në Kosovë në pjesën e parë të vitit 1999 ata ngarkuan në një kamion 21 trupa të shqiptarëve të Kosovës të cilët ishin të pidentifikuar dhe të vrarë në një lokacion të panjohur. Trupat i transportuan në kompleksin “Feronikl” ku ngarkuan shportën e vinçave me trupa mbi flakët e furrës së shpërthimit.¹¹ Ankesa penale është ngritur në bazë të informatave që FDH-ja i ka marrë, e të cilat janë paraqitur në dorëshkrimin e librit "Crtice" ["Reminiscences"] të shkruar nga Slobodan Maksimović. Një fragment nga libri i Maksimovićit i cili nuk është publikuar, mund të shërbejë për të

⁸ ICMP (2017), 'Personat e Pagjetur nga Konflikti i Kosovës dhe Pasojat e tij'. Në dispozicion në: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/Kosovo-stocktaking-ENG.pdf> [Qasur më: 13 gusht 2019].

⁹ ICMP (2017), 'Personat e Pagjetur nga Konflikti i Kosovës dhe Pasojat e tij', fq.23. Në dispozicion në: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/Kosovo-stocktaking-ENG.pdf> [Qasur më: 13 gusht 2019].

¹⁰ Po aty.

¹¹ Fondi për të Drejtën Humanitare, (2017), 'Mbulimi i provave të krimeve gjatë luftës në Kosovë: FSHEHJA E OPERACIONEVE TË TRUPAVE'. Në dispozicion në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=33299&lang=de> [Qasur më: 14 gusht, 2019].

përshkruar një ngjarje të veçantë. "Dy policë (një me nofkën "Çeda") dhe një shofer urdhërojnë të ngarkojnë në kamion trupat e 21 shqiptarëve dhe t'i djegin ata në kompleksin e fabrikës "Ferronikel". Autori përshkruan në detaje se si dukeshin djegiet e trupave, duke deklaruar se trupat ishin ngarkuar në një vinç "i cili përdoret për të derdhur hekur gjysëm të punuar në konvertuesit Bessemer të djegur".¹²

11. Sipas raportit të FDH-së, Slobodan Millosheviq, në atë kohë president i Republikës Federative të Jugosllavisë, në mars të vitit 1999 në një takim në Pallatin e Bardhë, ai dha urdhërin për të marrë masa në mënyrë që të eliminoheshin trupat tashmë të varrosur të civilëve shqiptarë. Është e rëndësishme të theksohet se në këtë takim morën pjesë njerëz në pozita të larta qeveritare, të policisë dhe udhëheqjes ushtarake. Përveç kësaj, raporti thekson se operacioni i fshehtë i urdhëruar në mars të vitit 1999 nga Slobodan Millosheviq për të mbuluar krimet, u zhvillua kryesisht gjatë muajve vijues. Për aktivitetet e operacionit, ishin përgjegjës oficerë të nivelit të lartë - dhe të mesëm të policisë dhe ushtrisë.¹³

12. Siç është përmendur tashmë, Tribunali dhe organizatat përfshirë Human Rights Watch (HRW), kishin mbledhur prova që sugjerorin se vendet e varrimit në Kosovë ishin të manipuluar me qëllim që t'i fshehnin provat. Sipas HRW kjo përfshinte "heqjen e trupave, rivarrosjen e trupave nga varrezat masive në varret individuale, djegien e kufomave dhe heqjen ose shkëmbimin e veshjeve dhe efekteve personale në mënyrë që të komplikojnë procesin e identifikimit".¹⁴

13. Konflikti i armatosur në Kosovë përfundoi me Marrëveshjen e Kumanovës. Forcat jugosllave dhe serbe ranë dakord të tërhiqeshin nga territori i Kosovës dhe të hapnin rrugën për praninë ndërkombëtare në Kosovë. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk përcaktoi çështjen e zhdukjes së detyruar dhe personave të pagjetur.

¹² Fondi për të Drejtën Humanitare, (2017), 'Mbulimi i provave të krimeve gjatë luftës në Kosovë: FSHEHJA E OPERACIONEVE TË TRUPAVE'. Në dispozicion në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=33299&lang=de> [Qasur më: 14 gusht, 2019].

¹³ Po aty.

¹⁴ Human Rights Watch (2001), 'NËN URDHËRA: Krimet e Luftës në Kosovë'. Në dispozicion në: <https://www.hrw.org/legacy/reports/2001/kosovo/> [Qasur më: 14 gusht 2019].

14. Përpjekjet dhe manipulimet e autoriteteve serbe për të fshehur provat e krimeve të luftës, ishin gati për t'u zbuluar në prill të vitit 2001. Sipas disa raporteve "trupat në kamion ishin vetëm maja e ajsbergut. Në total, mbetjet e të paktën 900 individëve janë zhvarrosur në Serbi, nga varreza masive ose individuale në tokën e Ministrisë së Brendshme të Serbisë në Batajnicë jashtë Beogradit, Petrovo Selo dhe Bajina Bashta, ku trupat e nxjerra nga Liqeni Peruçac ishin rivarrosur në 1999".¹⁵

3) Standardet Ndërkombëtare

15. KNKK-ja përcakton personin e pagjetur 'një person, vendndodhja e të cilit është e panjohur për të afërmit e tij dhe/ose i cili në bazë të informatave të besueshme, është raportuar i pagjetur në përputhje me legjislacionin kombëtar në lidhje me një konflikt të armatosur ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar, situatës së dhunës ose trazirave të brendshme, katastrofave natyrore ose ndonjë situatë tjetër që mund të kërkojë ndërhyrjen e një autoriteti kompetent shtetëror'.¹⁶

16. Neni 7 i Statutit të Romës të vitit 1998 të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GjNP) rendit zhdukjen e detyrueshme si një nga krimet kundër njerëzimit. Ky Nen përcakton zhdukjen me forcë si "arrestimi, ndalimi ose rrëmbimi i personave nga ose me autorizimin, mbështetjen ose pranimin e një shteti ose organizate politike, pasuar nga refuzimi për të pranuar këtë privim të lirisë ose për të dhënë informacion mbi fatin ose vendndodhjen e atyre personave, me qëllim që t'i heqin ata nga mbrojtja e ligjit për një periudhë të zgjatur".¹⁷

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Shërbimi Këshillues mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare (2009), 'ICRC'. Në dispozicion në: [file:///C:/Users/RIDEA%205/Downloads/model-law-missing-icrc-eng-%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/RIDEA%205/Downloads/model-law-missing-icrc-eng-%20(1).pdf) [Qasur më 13 gusht, 2019].

¹⁷ GjNP (1998), 'Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare'. Në dispozicion në: https://www.icc-cpi.int/nr/rdonlyres/ea9aeff7-5752-4f84-be94-0a655eb30e16/0/rome_statute_english.pdf [Qasur më: 14 gusht, 2019].

- 17.** Rezoluta e OKB-së A/RES/47/133 e 18 dhjetorit të vitit 1992 përmban Deklaratën mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, e cila përcakton "zhdukjen e detyruar si fakt që "personat janë arrestuar, ndaluar ose rrëmbyer kundër vullnetit të tyre ose ndryshe të privuar nga liria nga zyrtarë të degëve ose niveleve të ndryshme të qeverisë, ose nga grupe të organizuara ose individë privatë që veprojnë në emër të, ose me mbështetjen, direkte ose indirekte, pëlqimin ose pranimin e Qeverisë, pasuar nga refuzimi për të zbuluar fatin ose vendndodhjen e personave në fjalë ose refuzimin për të njohur privimin e lirisë së tyre, që i vendos personat e tillë jashtë mbrojtjes së ligjit".
- 18.** DNH rregullon masat që secila palë në konflikt duhet t'i llogarisë personat e pagjetur si pasojë e konfliktit dhe t'u sigurojë anëtarit të familjes së tyre informata për fatin e tyre.
- 19.** Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj) përcakton që anëtarët e familjeve të personave të pagjetur kanë të drejtë të dinë për sa i përket vendndodhjes së të afërmeve të tyre që nuk u gjetën.
- 20.** Konventat dhe Deklarata e Gjenevës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar të vitit 1949 parashikojnë shkëmbimin e informacionit midis palëve në konflikt lidhur me vendndodhjen e personave të pagjetur gjatë konfliktit.
- 21.** Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar parashikon mbrojtjen e të gjithë njerëzve që janë të përfshirë në hetimin e personave të pagjetur. Kjo Deklaratë gjithashtu përcakton që personat që kanë kryer zhdukje të detyruar nuk do të përfitojnë nga ndonjë ligj i veçantë amnistie ose masa të ngjashme që mund të kenë efekt të përjashtimit të tyre nga çdo procedim ose sanksion penal, dhe viktimat e zhdukjes së detyruar dhe familjet e tyre për të marrë dëmshpërblim dhe kompensim.

4) Legjislacioni i Kosovës

22. Instrumentet kryesore ekzistuese ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë përfshirë në Kushtetutën dhe legjislacionin e Kosovës. Në thelb, kjo siguron të drejtën e anëtarëve të familjeve të personave të pagjetur që të kenë informacion në lidhje me fatin dhe vendndodhjen e të afërmeve të tyre.
23. Ligji i Kosovës për Personat e Zhdukur (Nr. 03/L-023) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht të vitit 2011. Ky ligj synon të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të pagjetur dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Ligji fokusohet në mbrojtjen e të drejtës së anëtarëve të familjes për të ditur fatin e personave të cilët janë raportuar të pagjetur gjatë periudhës prej 1 janarit të vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 si pasojë e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
24. Ligji i Kosovës për Personat e Pagjetur përkufizon personin e pagjetur, person, vendndodhja e së cilit është e panjohur për anëtarët e familjes së tij/saj dhe kërkuesit, të cilët në bazë të informatave të besueshme u raportuan të pagjetur gjatë periudhës 1 janar të vitit 1998 - 31 dhjetor të vitit 2000, si pasojë e luftës gjatë viteve 1998-1999.
25. Pas miratimit të Ligjit për Personat e Pagjetur në Kosovë në gusht të vitit 2011, Qeveria e Kosovës miratoi Rregulloren për Punën e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur, i cili përcakton rregullat dhe procedurat e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Njësive Administrative të Komisionit.
26. Presidenti i Kosovës ka themeluar Ekipin Përgatitor të Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit në Kosovë me qëllim të përgatitjes së terrenit për krijimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit në Kosovë. Qëllimi i këtij komisioni është të dokumentojë dhe vendosë fakte për shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë të kaluarës së fundit të dhunshme, të rivendos dinjitetin të viktimave të të gjitha komuniteteve. Me një qëllim të tillë, komisioni shpreson të kontribuoj në transformimet shoqërore për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve dhe

abuzimeve të pësuar.¹⁸ Në prill të vitit 2018, presidenti emëroi ekipin përgatitor për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit dhe Rregulloren për Rregulla dhe Procedura të Ekipit Përgatitor për Themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.

5) Mekanizmat operues në Kosovë

27. Detyra për gjetjen, rikthimin dhe identifikimin e personave të pagjetur ka qenë kryesisht e ndarë nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, ndërsa në Serbi kjo detyrë kryesisht është ndërmarrë nga institucionet vendore, së pari të koordinuara nga Këshilli Koordinues i Kosovës dhe më vonë nga Komisioni Qeveritar i Serbisë për Personat e Pagjetur.

28. Menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur në qershor të vitit 1999, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjPNJ) ishte përgjegjëse për punën e zhvarrimit të hershëm në Kosovë. Qëllimi i saj kryesor ishin hetimet penale për të demonstruar se krimet ishin sistematike dhe të përhapura dhe për të mbledhur prova për ndjekjen penale të pjesëtarëve të udhëheqjes serbe, të cilët ishin paditur në maj 1999 nga GjPNJ për krimet e luftës në Kosovë. Ekipet e pavarura nga disa vende nën koordinimin e GjPNJ mbërritën me NATO-n në vitin 1999 në Kosovë. Në disa raste, ata identifikuan edhe mbetjet mortore. Trupat e paidentifikuar të zhvarrosur në vitin 1999 u rivarrosën në vende të cilat nuk ishin ndarë me UNMIK-un dhe institucionet e tjera të mandatuara për hetimin e rasteve të personave të pagjetur.

29. Deri në vitin 2001, identifikimi i trupave të zhvarrosur është bërë me mjete vizuale jo-shkencore, të tilla si njohja e veshjes së personit ose sendeve të tjera personale nga anëtarët e familjes. KNKK dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) botoi një seri librash "Books of Belongings" me gjësendet e gjetura të personave të zhvarrosur.

¹⁸ Presidenti i Republikës së Kosovës (2018), 'Deklaratë e ekipit përgatitor për themelimin e komisionit për të vërtetën dhe pajtimin'. Në dispozicion në: [https://www.president-ks.gov.net/repository/docs/2019_01_17_143317_DEKLARATE17119 .pdf](https://www.president-ks.gov.net/repository/docs/2019_01_17_143317_DEKLARATE17119.pdf) [Qasur më: 15 gusht 2019].

30. Në nëntor të vitit 1999, Njësia e Personave të Pagjetur (NjPP) është themeluar brenda Policisë së UNMIK-ut. Kjo njësi kishte për detyrë të hetonte lokacionet e mundshme të personave të pagjetur dhe varrezat. Ajo së bashku me Njësine Qendrore të Hetimeve Penale (NjQHP) të policisë së UNMIK-ut dhe Njesisë për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) ishin në krye për hetimin e aspekteve penale të rasteve të personave të pagjetur në Kosovë. Sipas raportit të ICMP-së, NjPP ishte përgjegjëse për kërkimin e urdhrave të gjykatës që autorizonin zhvarrime dhe për kryerjen e zhvarrimeve, së bashku me arkeologët mjeko-ligjorë dhe/ose antropologët. Si pasojë, NjPP deri në prill të vitit 2002 kishte kryer 69 zhvarrime dhe kishte kthyer rreth 85 trupa. Në maj të vitit 2000, për t'u marrë me identifikimin, kthimin dhe sistemimin e mbetjeve mortore u krijua Komisioni i Kthimit dhe Identifikimit të Viktimave (KKIV) i kryesuar nga UNMIK-u.¹⁹

31. Grupi Punues për Persona të Pagjetur në Lidhje me Ngjarjet në Kosovë (GP) në mes të janarit të vitit 1998 dhe dhjetorit të vitit 2000, u krijua në vitin 2004 nën patronazhin e përfaqësuesit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën si rezultat i dialogut të Vjenës i udhëhequr nga OKB. Ky grup punues mbajti seanca të rregullta në të cilat delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit shkëmbyen informacione dhe planifikuan aktivitete.

32. Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (ZPPML) në Departamentin e Drejtësisë u themelua nga UNMIK-u në vitin 2002. Kjo zyrë ishte autoriteti i vetëm në Kosovë me mandat për të përcaktuar vendndodhjen e personave të pagjetur, identifikimin e mbetjeve mortore të tyre dhe kthimin e tyre në familjet e personave të pagjetur. ZPPML ka kryer një varg aktivitete të specializuara - zhvarrosjet ligjore, ekzaminimin pas-vdekjes dhe krahasimin e të dhënave para-vdekjes dhe pas-vdekjes - deri në fund të vitit 2008. Në vitin 2007 kjo zyrë pjesërisht u transferua nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Në vitin 2008 kjo zyrë u morr përsipër nga misioni i EULEX-it.

¹⁹ ICMP (2017), 'Personat e Pagjetur nga Konflikti i Kosovës dhe Pasojat e tij', fq.15. Në dispozicion në: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/Kosovo-stocktaking-ENG.pdf> [Qasur më: 13 gusht 2019].

33.Në vitin 2003, pas disa vitesh të negociatave Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur (KNPP) dhe UNMIK nënshkruan një memorandum mirëkuptimi që konsiston në ndihmën teknike të KNPP-së për UNMIK-un. Procesi i gjatë i negociatave ishte i përqendruar në këmbënguljen e KNPP-së për përdorimin e ADN-së si identifikues primar i cili ishte kundërshtuar nga stafi i mjekësisë ligjore të UNMIK-ut, pasi ata ishin mësuar të përdorin metodat tradicionale të identifikimit. Megjithatë, u arrit marrëveshje për përdorimin e ADN-së, por UNMIK hodhi poshtë ofertën e KNPP-së për të ofruar ndihmë në gjurmimet dhe në ekzaminimin e mbetjeve mortore në Kosovë. Gabimet në identifikimin e trupave me metoda tradicionale kishin ndikim në identifikimin nga ADN-ja. Familjet të cilat dikur e kanë marrë gabimisht trupin ishin ngurrues të ofrojnë mostrat e ADN-së për identifikimin e ardhshëm. Prandaj, mbetjet e personave të pagjetur janë ende të paidentifikuara.

34.Në vitin 2006, KNPP-ja ofroi ndihmë autoriteteve të Qeverisë së Kosovës në krijimin e një Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur për të udhëhequr aktivitetet në lidhje me personat e pagjetur në territorin e Kosovës. Mandati i Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur përfshin mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të pagjetur dhe familjeve të tyre; koordinimin e aktiviteteve në mbledhjen e të dhënave lidhur me personat e pagjetur; themelimin e Regjistrimit Qendror të Personave të Pagjetur; informimin e anëtarëve të familjeve të personave të pagjetur dhe bashkëpunimin me shoqatat e tyre, duke njoftuar anëtarët e familjeve për fatin e personave të pagjetur; rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e iniciativave që lidhen me personat e pagjetur duke raportuar publikisht rezultatin e gjetjeve të tij; ndërmarrja e aktiviteteve të tjera të rëndësishme në lidhje me personat e pagjetur; bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në kryerjen e detyrave të saj; hapjen dhe regjistrimin e rasteve të personave të pagjetur; dhe duke paguar shpenzimet e varrimit të personave të pagjetur të identifikuar. Mandati i tij është në përputhje me mandatin e homologëve në rajon, përveç autoritetit politik për të kryer dhe koordinuar procesin e brendshëm ligjor për të hetuar rastet e personave të pagjetur nga konflikti.

35. Në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova, EULEX mori përgjegjësinë për çështjet e sundimit të ligjit, duke përfshirë çështjen e personave të pagjetur. EULEX-i ka vazhduar bashkëpunimin me KNPP-në në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga UNMIK-u dhe KNPP-ja në vitin 2003. EULEX-i mori përsipër funksionimin e ZPPML-së, i cili kishte mandat të dyfishtë: (1) qartësimin e fatit të personave të pagjetur dhe (2) sigurimin e një sistemi ligjor mjekësor të Standardeve Evropiane për Kosovën.

36. Për të përmirësuar punën e institucioneve të Kosovës mbi personat e pagjetur, Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) është themeluar me ligjin "*Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Ligji Nr. 03/L-137*", në qershor të vitit 2009 në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë, Departamenti i Mjekësisë Ligjore është organ kompetent publik duke pasur përgjegjësinë kryesore për të ofruar ekspertizën e mjekësisë ligjore, hetimet mjekësore për vdekjen dhe kthimin e mbetjeve mortore tek familjet e tyre. Më tutje, EULEX-i e mban mandatin e tij ekzekutiv në lidhje me personat e pagjetur dhe anëtari i stafit të EULEX-it ka qenë zëvendës drejtor i DML. Gjithashtu, DML-ja merr ndihmë nga stafi i EULEX-it në antropologjinë dhe arkeologjinë mjeko-ligjore, patologjinë mjeko-ligjore dhe hetimin e skenës së krimit. "DML-ja mban kontakte me familjet e të pagjeturve dhe është përgjegjës për gjetjen, zhvarrosjen, identifikimin dhe përcaktimin e fatit të të pagjeturve, si dhe dorëzimin e mbetjeve mortore të familjeve të personave të pagjetur".²⁰

37. Prokuroria Speciale e Kosovës (PSK) është themeluar në vitin 2008 dhe mandatuar në bazë të Konventave të Gjenevës, ndër të tjera, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe në konfliktet e armatosura të karakterit ndërkombëtar. PSK është përgjegjëse për hetimin e rasteve të zhdukjes së detyruar. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë thekson se PSK-ja ka kompetenca të plota për

²⁰ ICMP (2017), 'Personat e Pagjetur nga Konflikti i Kosovës dhe Pasojat e tij', fq.17. Në dispozicion në: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/Kosovo-stocktaking-ENG.pdf> [Qasur më: 13 gusht 2019].

të gjitha rastet, përfshirë rastet e zhdukjes së detyruar, të nisura pas 15 prillit të vitit 2014. Ekzekutimi i kompetencave të saj lidhur me rastet e personave të pagjetur është shumë i kufizuar për shkak të fillimit të shumicës së rasteve të personave të pagjetur para datës 15 prill të vitit 2014. Prandaj, shumica e këtyre rasteve mbeten nën vëzhgimin e EULEX-it.

38. Që nga viti 2008, kur disa prej kompetencave janë transferuar nga UNMIK-u tek EULEX-i, ky i fundit ka kryer 594 operacione në terren me qëllim identifikimin dhe ri-lidhjen e mbetjeve njerëzore. 506 viktima janë identifikuar dhe janë varrosur sipas dëshirës së familjeve të viktimës”.²¹

39. Përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës lidhur me rastet e personave të pagjetur janë shumë të kufizuara. EULEX-i ka ruajtur mandatin ekzekutiv në lidhje me personat e pagjetur. Ai kufizon aftësinë e Kosovës për t’u përballur me palën serbe në lidhje me personat e pagjetur, kufizon përgjegjësinë për lëshimin e personave të pagjetur dhe pjesëmarrjen në instrumente ligjore relevante ndërkombëtare.

40. “Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është një nga komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, i mandatuar nga Rregullorja e Punës së Kuvendit”.²² Një nga rolet e komisionit është të monitoroj zbatimin e ligjit dhe ligjeve të tjera tashmë ekzistuese. Bazuar në vetë emrin, komisioni përfshin fushëveprimin e tij në të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, personat e pagjetur dhe peticione. Kështu që, komisioni ka të drejtë të bëjë peticione, duke ngritur një shqetësim për ndonjë çështje në Kuvendin e Kosovës. Në rast të ngritjes së peticionit nga një individ në Kuvendin e Kosovës, peticioni do t’i kalojë këtij komisioni dhe pas shqyrtimit do të rekomandohet se në cilin institucion duhet të dërgohet peticioni.

²¹ EULEX, (2018), ‘Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë’. Në dispozicion në: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,813> [Qasur më: 15 gusht 2019].

²² Misioni i OSBE-së në Kosovë (2009) ‘Ushtroni të drejtat tuaja! Një katalog i mjeteve juridike dhe asistencë për anëtarët e komunitetit’. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/73421?download=true> [Qasur më: 14 gusht, 2019].

6) Argumentet që Përshkruajnë Detyrimet Ligjore të Qeverisë së Serbisë ndaj Kosovës

41. Ka arsye bindëse pse Kosova dhe Serbia duhet të bashkëpunojnë për zbulimin e fatit të personave të pagjetur. Këto arsye janë artikuluar në këto argumente: (1) Qeveria e Serbisë dhe institucionet përkatëse duhet të respektojnë dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare në lidhje me personat e pagjetur; (2) Familjet e personave të pagjetur duhet të gëzojnë të drejtën për të ditur lidhur me fatin e të afërmeve të tyre që nuk u gjetën si pasojë e konfliktit të armatosur; (3) Kosova dhe Serbia duhet të bashkëpunojnë për të zbuluar fatin e personave të pagjetur; (4) Bashkëpunimi i Qeverisë së Serbisë dhe institucioneve përkatëse duhet të tregojë se Serbia po kontribuon për paqen dhe marrëdhëniet paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

6.1) Qeveria e Serbisë dhe institucionet përkatëse duhet të respektojnë dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare lidhur me Personat e Pagjetur

42. Instrumentet ndërkombëtare që lidhen me personat e pagjetur trajtojnë detyrimet lidhur me sigurimin e informatave. Njëra prej tyre është Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, e cila kërkon që palët shtetërore të kodifikojnë dhe të ndëshkojnë sipas legjislacionit penal, dështimin e regjistrimit të personave të privuar nga liria; regjistrimin e të dhënave të pasakta në lidhje me personat e privuar nga liria; refuzimin e dhënies së informacionit për personat e privuar nga liria; dhe falsifikimin, fshehjen ose shkatërrimin e dokumenteve që vërtetojnë identitetin e vërtetë të fëmijëve si rezultat i zhdukjes së detyruar (Nenet 22 dhe 25). Nenet tjera të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar janë Nenet 14 dhe 15, ku thuhet se palët duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të madhe të ndihmës së ndërsjellë juridike në lidhje me procedurat penale të sjella në lidhje me zhdukjet e detyruara dhe bashkëveprojnë me synimin për të ndihmuar viktimat e zhdukjes së detyruar; si kërkimi, gjetja dhe lirimi i personave të pagjetur; dhe, në rast të vdekjes, në zhvarrosjen dhe identifikimin e tyre dhe

kthimin e mbetjeve të tyre. Neni 17 parasheh që askush nuk do të mbahet në paraburgim sekret. Varreza në Rudnicë u hap pas 15 vjetësh. Në atë varrezë u gjetën 54 trupa shqiptarë. Kjo do të thotë se Serbia ka refuzuar të ofrojë informacion në lidhje me personat e pagjetur. Serbia duhet të hapë arkivat e policisë dhe ushtrisë.²³ Dhënia e informatave të plota relevante nga Serbia lidhur me personat e pagjetur do të ishte një tregues se Serbia do t'i përmbushë këto standarde.

43. Duke u bazuar në Nenin 17 të Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, “zhdukja e detyruar duhet të konsiderohet një shkelje e vazhdueshme për aq kohë sa autorët vazhdojnë të fshehin fatin dhe vendndodhjen e të pagjeturve dhe këto fakte mbeten të paqarta. Kjo deklaratë përfshin sanksionet që shtetet duhet të sigurojnë që të gjithë ata që përfshihen në hetim, duke përfshirë të afërmit, avokatët, dëshmitarët dhe ata që kryejnë hetimin, janë të mbrojtur nga ndëshkim’.²⁴ Serbët nuk sigurojnë informacione për vendndodhjen e personave të pagjetur sepse janë të frikësuar nga ndjekja penale²⁵. Ndonjëherë, Serbia ka hapur varreza për përfitime politike, por të rivarrosurit mbesin të paidentifikuar.²⁶

44. Duke u bazuar në Nenin 16 dhe 17 të Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, personat që supozohet se kanë kryer zhdukje të detyruar nuk do të përfitojnë nga ndonjë ligj i veçantë për amnisti ose masa të ngjashme që mund të kenë efektin e përjashtimit të tyre nga ndonjë vepër penale ose sanksione. Neni 19 përcakton që viktimat e zhdukjes së detyruar dhe familjet e tyre do të marrin dëmshpërblim dhe do të kenë të drejtën për kompensim adekuat, duke përfshirë mjetet për një rehabilitim sa më të plotë të mundshëm.

²³ Intervista 1, 1., (2018), *Përfaqësues i Fondit për të Drejtën Humanitare në Prishtinë* [Intervistë] (22 nëntor 2018).

²⁴ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1992) ‘Deklaratë e Mbrojtjes së të gjithë personave nga zhdukja e detyruar’. Në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/enforceddisappearance.aspx> [Qasur më 13 gusht 2019].

²⁵ Intervista 2, 2., (2018). *Këshilltar i Kryeministrit & i emëruar Mbjatës i dosjes mbi Çështjen e Personave të Pagjetur* [Intervistë] (22 nëntor 2018).

²⁶ Intervista 4, 4., (2018). *Përfaqësuesi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (26 nëntor 2018).

Familjet e personave të pagjetur kanë shumë nevoja të tjera, jo vetëm kthimin e mbetjeve.²⁷

45. Pas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme, Rezoluta e OKB-së A/RES/47/133, Komisioni për të Drejtat e Njeriut krijoi një grup punues për të hartuar një instrument normativ ligjërish të detyrueshëm për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyruar. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2010. Ky instrument merret me zhdukjen e detyruar, duke specifikuar detyrimet e shteteve për parandalimin e praktikës, hetimin dhe sanksionimin e përgjegjësve dhe miratimin e masave adekuate për të siguruar të drejtat e viktimave. Kjo konventë përcakton se shtetet palë duhet të kodifikojnë zhdukjen e detyruar si një vepër të veçantë penale nën legjislacionin e tyre të brendshëm, duke mbajtur përgjegjësi penale çdo person i cili kryen, urdhëron, kërkon ose shkakton kryerjen, përpjeket për të kryer, është bashkëpunëtor ose merr pjesë në zbatimin e një zhdukje të detyruar.

46. Palët shtetërore gjithashtu duhet të vendosin kompetencën e tyre për të ushtruar juridiksionin për veprën penale të zhdukjes së detyruar, duke përfshirë kur personat e akuzuar për kryerjen e krimit jashtë vendit janë të pranishëm në ndonjë territor nën juridiksionin e tyre, përveç nëse personat e përmendur janë ekstraduar ose dorëzuar në një shtet tjetër ose në një gjykatë penale ndërkombëtare (Nenet 9 deri 11 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar).

47. Neni 24.2 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar përmbledh “të drejtën e viktimave për të ditur të vërtetën në lidhje me rrethanat e zhdukjes së detyruar, progresin dhe rezultatet e hetimit, si dhe fatin e personit të pagjetur”. Neni 24.3 kërkon që palët shtetërore “të marrin të gjitha masat e duhura për të kërkuar, gjetur dhe liruar personat e pagjetur dhe, në rast vdekjeje, të gjejnë, respektojnë dhe t'i kthejnë mbetjet e tyre”. Ndërsa Neni

²⁷ Intervista 3, 3., (2018). *Përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (26 nëntor 2018).

24.6 kërkon që palët shtetërore “të ndërmarrin hapat e duhur për të rregulluar gjendjen juridike të personave të pagjetur, fati i të cilëve nuk është sqaruar”.

48. Sipas Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut (KEDNj), anëtarët e familjeve të personave të pagjetur kanë të drejtën e informimit në lidhje me fatin dhe vendndodhjen e të afërmve të tyre, i cili është i ankoruar në Nenet 2, 3, 5 dhe 8 të KEDNj-së.

6.2) Familjet e personave të pagjetur duhet të gëzojnë të drejtën për të ditur lidhur me fatin e të afërmve të tyre që nuk u gjetën si pasojë e konfliktit të armatosur

49. Edhe pse Neni 24.2 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar përmban të drejtën e ‘viktimave për të ditur të vërtetën lidhur me rrethanat e zhdukjes së detyruar, progresin dhe rezultatet e hetimit, dhe fatin e personit të pagjetur’ dhe Neni 24.3 kërkon që palët shtetërore të marrin të gjitha masat për të kërkuar, gjetur dhe liruar personat e pagjetur dhe, në rast vdekjeje, të gjejnë, respektojnë dhe t’i kthejnë mbetjet e tyre. Neni 32 i Protokollit Shtesë I i Konventës së Gjenevës thekson se ‘me përfshirjen e të pagjeturve dhe të vdekurve në paragrafin III të këtij Protokollit Shtesë, e drejta e anëtarëve të familjes të dinë për fatin e të afërmve të tyre legjitimohet’, familjet e personave të pagjetur në Kosovë nuk e gëzojnë këtë të drejtë sepse Serbia nuk ndan informacionin lidhur me vendndodhjen e personave të pagjetur.

50. Përveç kësaj, në një rezolutë të miratuar në vitin 2002, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut pohoi “të drejtën e familjeve për të ditur fatin e të afërmve të tyre të raportuar si të pagjetur në lidhje me konfliktin e armatosur”.²⁸

51. Neni 24.7 i Komitetit për Zhdukjen e Detyruar (KZhd), thekson se “palët shtetërore janë të detyruara të garantojnë të drejtën për të formuar dhe për të

²⁸ Komisioni i OKB për të Drejtat e Njeriut, (2002), ‘Rezolutë 2002/60’. Në dispozicion në: https://ap.ohchr.org/documents/alldocs.aspx?doc_id=4920 [Qasur më: 13 gusht, 2019].

marrë pjesë lirshëm në organizata dhe shoqata të përfshira në përpjekjet për të përcaktuar rrethanat e zhdukjeve të detyruara dhe fatin e personave të pagjetur, dhe për të ndihmuar viktimat e zhdukjes së detyruar". Kjo garanton të drejtën për të themeluar Komisionin e Përbashkët të së Vërtetës dhe Pajtitimit me qëllim të përcaktimit të rrethanave të zhdukjes së detyruar të personave të pagjetur dhe fatit të tyre.

52. Rezoluta e miratuar e Konferencës së 26-të të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe thekson se: *"Kërkohet me ngulm që shtetet dhe palët e përfshira në konfliktet e armatosura të sigurojnë informacionin e nevojshëm për fatin e të pagjeturve për anëtarët e familjeve së tyre"*. Ky është obligim gjithashtu edhe për Serbinë për sa i përket listës së shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

53. Familjet e personave të pagjetur po kërkojnë në mënyrë aktive të drejtën e tyre për të ditur. Ata vazhdimisht llojnë dhe avokojnë për informacione në lidhje me anëtarët e pagjetur të familjeve së tyre. Protestat dhe grevat e urisë ishin të dukshme që nga fundi i konfliktit të armatosur në vitin 1999. P.sh. në vitin 2002, Nesrete Kumnova, themeluese e organizatës së Apelit të Nënave, u bashkua me prindërit e tjerë për të lobuar për informacion rreth asaj që ndodhi me të dashurit e tyre. Ato organizuan greva urie, të cilat zgjatën për 16 ditë dhe protestuan në Gjakovë dhe Prishtinë. Përvoja e urisë ishte rraskapitëse. "Të jesh e trishtuar dhe kur ke dhimbjen tënde me ty, është shumë e vështirë për ta trajtuar atë. Por kjo është zgjidhja e vetme që kam pasur", thotë Nesretja.²⁹ Familjet e personave të pagjetur nxorën një apel të përbashkët tek autoritetet në kryeqytetin serb, Beograd; kryeqytetin kosovar, Prishtinë; dhe bashkësinë ndërkombëtare, duke kërkuar emërimin e një përfaqësuesi të lartë për t'i dhënë fund vuajtjeve të tyre duke rimarrë eshtrat e të dashurve të tyre. Bajram Qerkinaj, përfaqësues i familjeve, tha se "procesi ka stagnuar dhe duhet të ringjallet dhe të përshpejtohet. Ne kemi arritur pikën kur do të ishim të lumtur të gjejmë edhe një pjesë të trupave të të dashurve tanë," tha ai. "Kjo është ajo që lumturia familjare mund të jetë për

²⁹ News Statsmen (2018), 'Në Kosovën e pavarur, familjet ende në kërkim të fëmijëve të tyre'. Në dispozicion në: <https://www.newstatesman.com/world/europe/2018/02/independent-kosovo-families-still-search-their-missing-children> [Qasur më: 14 gusht 2019].

ne tani - në mënyrë që familjarët të paktën të dinë se ku munden ta dërgojnë një lule, ose që tani të mund të mbajnë zi për anëtarët e tyre”.³⁰

6.3) Kosova dhe Serbia duhet të bashkëpunojnë për të zbuluar fatin e personave të pagjetur

54. Sipas Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, (2018), njerëzit në Kosovë kanë një perceptim të përbashkët që ushtria serbe ka dëshmi dhe të dhëna të plota për vendndodhjet e varrezave dhe se institucioni Serb ende nuk i ka hapur plotësisht arkivat. Qeveria e Kosovës ka siguruar gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar në zbulimin e fatit dhe vendndodhjen e personave të pagjetur. Zëdhënësi i Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur tha se ata kanë një interes veçanërisht për vendet brenda Serbisë në zonat e Rashkës dhe Novi Pazarit. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticion ka ftuar disa anëtarë të parlamentit serb përgjegjës për personat e pagjetur, por asnjëherë nuk janë përgjigjur në ftesat e tilla³¹. Ka tregues se në Batajnicë ekziston një varrezë. Ne kërkuam që Qeveria Serbe të hetonte këtë rast, por ata nuk iu përgjigjën kësaj kërkesë. Në vend që të hapin këtë varrezë, të riparojnë dhe të identifikojnë eshtrat, ata ndërtuan kishë në këtë pjesë.³² Ka një dokument që përfshin detajet e 22 shqiptarëve të ekzekutuar në Devë (Gjakovë) dhe që më pas u transferuan në Kalludër nga ushtria serbe.³³ Në Krukuvac, Rudnicë dhe Petrovo selo ka një person që ka dëshmuar transportimin e dy kamionëve me rreth 250 deri në 450 shqiptarë. Vetëm 52 prej tyre u kthyen.³⁴

³⁰ Zëri i Amerikës, (2017), 'Familjet e të zhdukurve në Kosovë duan të dinë fatin e të dashurve'. Në dispozicion në: <https://www.voanews.com/europe/families-missing-kosovo-want-know-fate-loved-ones> [Qasur më: 15 gusht 2019].

³¹ Intervista 6, 6., (2018). *Përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (05 dhjetor 2018).

³² Intervista 6, 6., (2018). *Përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (05 dhjetor 2018).

³³ Intervista 5, 5., (2018), *Shoqata e Familjeve të Personave të Pagjetur "Zëri i Prindërve"* [Intervistë] (22 nëntor 2018).

³⁴ Intervista 5, 5., (2018), *Shoqata e Familjeve të Personave të Pagjetur "Zëri i Prindërve"* [Intervistë] (22 nëntor 2018).

55. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar rregullon bashkëpunimin ndërmjet palëve shtetërore lidhur me zhdukjen e detyruar. Nenet 14 dhe 15 të kësaj Konvente theksojnë se 'palët shtetërore duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të madhe të ndihmës së ndërsjellë juridike në lidhje me procedurat penale të sjella në lidhje me zhdukjet e detyruara dhe të bashkëpunojnë për të ndihmuar viktimat e zhdukjes së detyruar; kërkimin, gjetjen dhe lirimimin e personave të pagjetur; dhe, në rast të vdekjes, në zhvarrosjen dhe identifikimin e tyre dhe kthimin e mbetjeve të tyre'. Sipas Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut (KEDNJ), anëtarët e familjeve të personave të pagjetur kanë të drejtën e informimit lidhur me fatin dhe vendndodhjen e të afërmeve të tyre, i cili është i ankoruar në Nenet 2, 3, 5 dhe 8 të KEDNJ-së. Në kontekstin e Kosovës, kjo konventë e obligon Serbinë të kërkojë, lokalizojë, riparojë, zhvarrosë dhe identifikojë personat e pagjetur nga konflikti i armatosur 1998-1999. Meqenëse Marrëveshja e Kumanovës nuk përfshinte gatishmëri lidhur me personat e pagjetur, tani është koha për të diskutuar këtë çështje dhe për të detyruar Serbinë të zbulojë informacionin e duhur dhe të marrë pjesë në zgjidhjen e rasteve të personave të pagjetur.

56. Në përputhje me Nenin 26 dhe 27 të Konventës së Katërt të Gjenevës, qeveria serbe dhe institucionet përgjegjëse duhet të ndajnë informacionin në mënyrë aktive në lidhje me personat e pagjetur dhe të kërkojnë në mënyrë aktive personat e pagjetur. Qeveria serbe duhet të shmanget nga mbajtja e informacionit mbi personat e pagjetur që janë me origjinë kosovare.

57. Konventat e Gjenevës të vitit 1949 parashikojnë ngritjen e Zyrave të Informacionit të mandatuara për centralizimin e informacionit mbi të burgosurit e luftës dhe civilët që i përkasin një pale të kundërt, t'ua bartin informacionet palëve, dhe të kërkojnë ndriçimin e fatit dhe vendndodhjen e personave të pagjetur. Në përputhje me këtë konventë është iniciativa e KNPP-së për bazën e të dhënave të personave të pagjetur. Në dhjetor të vitit 2017 në Beograd, KNPP thirri një takim rajonal për të paraqitur bazën e të dhënave të rasteve aktive të personave të pagjetur nga konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi. Pjesëmarrja në një bazë të dhënash të integruar rajonale do të ishte veçanërisht e dobishme për llogaritjen e

personave të pagjetur nga Kosova në konflikte të armatosura në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë gjatë viteve të 90-ta.³⁵ Pasurimi i një baze të tillë të dhënash me informacionin e mbledhur nga njerëzit, dëshmitarët, dokumentet zyrtare/dosjet nga Serbia do të ishte vendimtar në bashkëpunimin për llogaritjen e personave të pagjetur. Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit do të verifikonte rregullisht dhe do të hetonte më tej rastet dhe pastaj do të vazhdonte me hapa konkretë në gjetjen, kthimin dhe identifikimin. Procedurat e këtij komiteti duhet të mbikëqyren nga palët e interesuara ndërkombëtare në mënyrë që të shmangen humbjet ose fshehja e informacionit.

58. Në kontekstin e procesit të Berlinit në Samitin e pestë të Ballkanit Perëndimor më 10 korrik 2018 u takuan kryeministrat e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Ata nënshkruan Deklaratën e Përbashkët mbi Krimet e Luftës dhe Personat e Pagjetur në Kuadrin e Procesit të Berlinit. Kjo thekson rëndësinë e madhe për gjetjen e personave të pagjetur në territorin e ish-Jugosllavisë, duke sqaruar rrethanat e zhdukjes së tyre dhe sjelljen e atyre që janë përgjegjës para drejtësisë (Ballkani Perëndimor Evropian, 2018). Kjo deklaratë përfshin pikat e mëposhtme: *(1) të sigurojë hetime të paanshme dhe efektive për rastet e personave të pagjetur në përputhje me standardet ndërkombëtare të së drejtave të njeriut dhe të zgjidhë sa më shumë raste të personave të pagjetur gjatë pesë viteve të ardhshme; (2) të angazhohen në mënyrë proaktive të gjitha institucionet vendore që janë përgjegjëse ose të përfshira në gjetjen dhe/ose identifikimin e personave të pagjetur për të eksploruar të gjitha rrugët e mundshme për të marrë informata të reja rreth varrezave, duke përfshirë një angazhim në mënyrë adekuate për kërkimin e arkivave për informacionin përkatës, dhe transmetimin e këtij informacioni tek institucioni qendror përkatës; (3) t'i sigurojë institucionit kompetent qendror nga secili prej pjesëmarrësve të Procesit të Berlinit përgjegjës për kërkimin dhe/ose identifikimin e personave të pagjetur burimet adekuate njerëzore dhe buxhetore për të përmbushur mandatin e tyre; (4) për të siguruar angazhimin aktiv të familjeve të së pagjeturve në procesin e*

³⁵ICMP (2017), 'Takimi rajonal i Ballkanit Perëndimor lanson bazën e të dhënave të rasteve të personave të humbur aktivë nga konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi'. Në dispozicion në: <https://www.icmp.int/flash-news/western-balkans-regional-meeting-launches-database-of-active-missing-persons-cases-from-the-armed-conflicts-in-the-former-yugoslavia/> [Qasur më: 13 gusht 2019].

kërkimit dhe/ose gjetjes së të pagjeturve; (5) të sigurojë që informacionet e besueshme dhe të sakta mbi procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të pagjetur të bëhen publike; (6) të angazhohet për të zhvilluar institucione të mëtutjeshme mjeko-ligjore dhe për të siguruar mbështetje dhe financim të vazhdueshëm institucional për këtë; (7) të sigurojnë që familjet janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre, duke përfshirë harmonizimin dhe zbatimin plotësisht të legjislacionit vendas në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare; (8) të adresojë në mënyrë adekuate nevojat e familjeve të personave të pagjetur; dhe (9) të përmbahen nga ndonjë politizim i çështjes së personave të pagjetur.³⁶ Serbia duhet të bëjë përpjekje konkrete për të zbatuar secilën pikë të kësaj deklaratë.

59. Në bazë të Nenit 19 të Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, viktimat e zhdukjes së detyruar dhe familjet e tyre do të marrin dëmshpërblim dhe do të kenë të drejtën e kompensimit adekuat, duke përfshirë mjetet për rehabilitimin sa më të plotë të mundshëm. Për të përmbushur këtë standard në mënyrë adekuate, Serbia është e detyruar të sigurojë kompensimin dhe kthimin për të gjithë viktimat e zhdukjes së detyruar dhe familjeve të tyre. Kjo duhet të specifikohet në termat e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit.

60. Misioni i EULEX-it po përfundon. Kjo nënkupton që institucionet e Kosovës duhet të kenë rolin e pronësisë dhe udhëheqjes në përpjekjet për të zgjidhur rastet e personave të pagjetur. Për këtë, Qeveria e Kosovës duhet të insistoj që Qeveria e Serbisë të përmbush standardet ndërkombëtare në lidhje me personat e pagjetur.

6.4) Bashkëpunimi i Qeverisë së Serbisë dhe institucioneve përkatëse duhet të tregojë se Serbia po kontribuon për paqen dhe marrëdhëniet paqësore midis Kosovës dhe Serbisë

³⁶ Samiti i Ballkanit Perëndimor (2018), 'Deklarata të përbashkëta për bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, krimet e luftës dhe personat e zhdukur në kuadër të Procesit të Berlinit'. Në dispozicion në: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/724294/180710_WBS_Joint_Declarations.pdf [Qasur më: 14 gusht 2019].

- 61.** Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë dhe pajtimi është shumë larg pa ndarë informacione për personat e pagjetur. Ka pasur disa protesta nga familjet e personave të pagjetur që kërkojnë nga institucionet e Kosovës dhe organet përgjegjëse ta vendosin çështjen e personave të pagjetur si një parakusht për bisedime me Serbinë³⁷. Është e pamundshme të ndërtohen marrëdhënie të mira fqinjësore pa zgjidhur rastet e personave të pagjetur.³⁸
- 62.** Përveç kësaj, sipas Nenit 24.7 të Komitetit për Zhdukjen e Detyruar (KZhd), “palët shtetërore janë të detyruara të garantojnë të drejtën për të formuar dhe për të marrë pjesë lirshëm në organizata dhe shoqata të lidhura me përpjekjen për të përcaktuar rrethanat e zhdukjeve të detyruara dhe fatin e personave të pagjetur, dhe për të ndihmuar viktimat e zhdukjes së detyruar”. Serbia duhet të bëjë përpjekje konkrete për të siguruar që serbët që jetojnë në Kosovë dhe Serbi janë të lirë të krijojnë ose të marrin pjesë në asociacione ose organizata të tilla.
- 63.** Udhëheqësi i Shoqatës së Personave të Pagjetur, Bajram Qerkinaj thotë se autoritetet dhe bashkësia ndërkombëtare nuk janë plotësisht të angazhuar në adresimin e kësaj çështjeje. Qerkinaj tha gjithashtu se kjo temë duhet të përfshihet në bisedimet që po mbahen në Bruksel, sepse nëse kjo çështje nuk trajtohet, kurrë nuk mund të ketë pajtim ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve.³⁹
- 64.** Urrejtja dhe mosbesimi ndërmjet shqiptarëve në Kosovë dhe serbëve janë akoma të pranishme, madje edhe midis grupeve të angazhuara për të njëjtën arsye. Një shembull është mungesa e besimit midis familjeve të personave të pagjetur nga komuniteti shqiptar dhe familjeve të personave të pagjetur të komunitetit serb. Shumë serbë gjithashtu humbën anëtarët e familjes në luftime, por dialogu është i pamundur për shqiptarët, thotë Nesrete Kumnova. "Serbët janë të gjithë të njëjtë,

³⁷ Balkan Insight (2012), ‘Kosovë: Familjet e Personave të Zhdukur protestojnë’. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2012/05/15/kosovo-families-of-missing-persons-protest/> [Qasur më: 15 gusht, 2019].

³⁸ Intervista 7, 7., (2018). *Përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (30 11 2018).

³⁹ Independent Balkan News Agency, (2018), ‘Fati i personave të zhdukur në Kosovë ende nuk është adresuar’. Në dispozicion në: <https://balkaneu.com/the-fate-of-missing-persons-in-kosovo-is-yet-to-be-addressed/> [Qasur më: 13 gusht 2019].

ata gjithmonë kanë qenë të tillë", thotë ajo. "Pothuajse të gjithë janë kriminelë. Ne nuk kemi besim tek ata. Edhe në të kaluarën në kohën e gjyshërve tanë, ata rrinin së bashku. Ata do të mbanin një sëpatë nën jastëkun e tyre dhe do të mendonin se si të vrisnin një shqiptar. Kur ata lindin, ata lindin kriminelë."⁴⁰ Themelimi i Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit do të kontribuonte për të ndërtuar besimin, për të ndarë informacionin dhe për të ecur përpara drejt pajtitimit. Mbështetja nga qeveria serbe në këtë iniciativë do të kontribuonte në ndërtimin e besimit.

65. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2010. Ky instrument trajton zhdukjen e detyruar, duke specifikuar detyrimet e shteteve në drejtim të parandalimit të praktikës, hetimit dhe sanksionimit të përgjegjësve dhe miratimin e masave adekuate për të siguruar të drejtat e viktimave. Kjo konventë përcakton se palët shtetërore duhet të kodifikojnë zhdukjen e detyruar si një vepër të veçantë penale nën legjislacionin e tyre të brendshëm, duke mbajtur përgjegjësi penale çdo personi i cili kryen, urdhëron, kërkon ose shkakton kryerjen e veprës, tenton për të kryer, është bashkëpunëtor ose merr pjesë në zbatimin e një zhdukjeje. Bazuar në Nenin 16 dhe 17 të kësaj Konvente, personat që pretendohet se kanë kryer zhdukje të detyruar nuk do të përfitojnë nga ndonjë ligj i veçantë amnistie ose masa të ngjashme që mund të kenë efektin e përjashtimit të tyre nga ndonjë procedim penal ose sanksione. Respektimi i kësaj konvente duke sjellë personat e dyshuar para drejtësisë do të kontribuonte ndjeshëm në ndërtimin e besimit. Serbia duhet të bashkëpunojë me Kosovën në përpunimin e rasteve të krimeve të luftës.⁴¹

66. Për të ndihmuar shoqëritë për të kapërcyer vuajtjet dhe ndarjen e shkaktuar nga konflikti i armatosur në vitet 1998-1999 dhe për të nxitur pajtimin, ngritja e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit do të ishte shumë e rëndësishme. Ky komision nuk do të zëvendësonte drejtësinë, por do të kontribuonte në

⁴⁰News Statsmen (2018), 'Në Kosovën e pavarur, familjet ende në kërkim të fëmijëve të tyre'. Në dispozicion në: <https://www.newstatesman.com/world/europe/2018/02/independent-kosovo-families-still-search-their-missing-children> [Qasur më: 14 gusht 2019].

⁴¹ Intervista 1, 1., (2018), *Përfaqësues i Fondit për të Drejtën Humanitare në Prishtinë* [Intervistë] (22 nëntor 2018).

dokumentimin dhe përcaktimin e fakteve të shkeljes gjatë këtij konflikti të armatosur, rivendosjen e dinjitetit të të gjitha komuniteteve, do të kontribuonte në transformimin shoqëror për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve dhe abuzimeve të pësuar. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione do të kontribuonte në përgatitjen e legjislacionit për themelimin e këtij Komisioni. Themelimi i një Komisioni të Përbashkët të së Vërtetës dhe Pajtitimit, i kryesuar nga Presidenti i Kosovës dhe i Serbisë, do të kontribuonte ndjeshëm në shkëmbimin e informatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke përparuar në mënyrë të konsiderueshme në llogaritjen e personave të pagjetur. Rekomandohet që ky komitet të mbikëqyret nga palët relevante ndërkombëtare në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti, angazhimi dhe llogaridhënia dhe të shmanget çdo bojkot i mundshëm.

67. Është e rëndësishme për të përkujtuar personat e pagjetur.⁴² Është e këshillueshme që të angazhohen familjet e personave të pagjetur dhe shoqatave të tyre në iniciativa për përkujtim. Bazuar në preferencat e familjeve të personave të pagjetur dhe standardeve vendore dhe ndërkombëtare për të vendosur vendet përkujtimore dhe ritualet e përkujtimit. Për të siguruar përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, iniciativa të tilla duhet të jenë gjithëpërfshirëse për të gjitha komunitetet etnike, dhe jo iniciativa të ndara përkujtimore për çdo komunitet etnik. Rekomandohet të vendosen vende përkujtimore të përbashkëta për të gjithë personat e pagjetur. Ky vend memorial do të ndihmonte familjet e personave të pagjetur që të kalonin procesin e zisë/vuajtjes për të dashurit e tyre, të cilët u zhdukën gjatë dhe pas luftës. Mbetjet e personave të pagjetur që nuk mund të identifikohen mund të varrosen në një varrezë të përbashkët e cila duhet të jetë gjithashtu një vend përkujtimor. Themelimi i një muzeu me artefaktet e personave të pagjetur do të ishte i dobishëm për të adresuar nevojën psikologjike të familjeve të personave të pagjetur për njohjen e fatit të tyre. Përkujtimi duhet të jetë pjesë e misionit të Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit.

⁴² Intervista 4, 4., (2018). *Përfaqësuesi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione* [Intervistë] (26 nëntor 2018).

7) Përfundimet

68. Serbia ka informacion në lidhje me zhdukjen e detyruar gjatë konfliktit të armatosur në vitet 1998-1999 dhe pasojat e tij. Megjithëse një numër i madh prej tyre janë gjetur, ende rezultojnë të pagjetur 1,647 persona. Pavarësisht nga standardet ndërkombëtare që sanksionojnë zhdukjen e detyruar dhe u detyrojnë palëve përgjegjëse të ndajnë informacion mbi vendndodhjen e personave të pagjetur, Serbia nuk i ka ndarë ato informata ende dhe nuk ka dënuar personat përgjegjës për zhdukje të tilla.
69. Gjatë konfliktit të armatosur, forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe manipuluan viktimat duke i vrarë ata, duke iu ndryshuar pamjen dhe vendndodhjen e tyre. Kishte raste që ata ndryshuan rrobat e viktimave dhe gjërat e tjera që u takonin; duke i djegur ato në vende të caktuara; i rimorën ata nga ato vende; dhe pastaj i riarrosën ata diku tjetër ose i dogjën mbetjet e tyre. Ka vende të dyshuara në Serbi ku janë riarrosur apo djegur viktimat nga Kosova. Burimet ushtarake, paraushtarake dhe burime të tjera zyrtare posedojnë dosjet në lidhje me informacionin e tyre.
70. Serbia nuk i ka dënuar personat përgjegjës për zhdukjet e detyruara dhe personat që kanë fshehur informacionin dhe faktet lidhur me vendndodhjen e personave të pagjetur.
71. Serbia nuk ka bërë ndonjë përpjekje për gjetjen e së vërtetës dhe pajtimin duke u marrë me të kaluarën. Është e qartë se Serbia nuk po ndan informacion ose hapë dosjet që kanë të bëjnë me vendndodhjen e personave të pagjetur, duke mos i lejuar njerëzit të ndajnë informacion dhe duke mos inkurajuar komunitetet që të gjejnë në mënyrë aktive të vërtetën rreth vendndodhjes së personave të pagjetur.
72. Serbia nuk po bën përpjekje për të bashkëpunuar me Kosovën sa i përket personave të pagjetur. Kjo çështje po bëhet më serioze pasi që misioni i EULEX-it, i cili kishte një rol vendimtar për personat e pagjetur në Kosovë, po përmbillet dhe Kosova duhet të marrë pronësinë mbi këtë çështje.

8) Rekomandimet

- 73.** Diskutimi i çështjes së personave të pagjetur në dialogun me Serbinë është një domosdoshmëri.
- 74.** Kosova duhet të insistoj në adresimin e çështjes së të pagjeturve në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare.
- 75.** Kosova duhet ta kushtëzojë Serbinë të hapë të gjitha dosjet dhe informacionet që kanë të bëjnë me personat e pagjetur.
- 76.** Serbia duhet të përgatis raporte për vendndodhjen e të gjithë personave të cilët nuk janë gjetur gjatë këtij konflikti të armatosur, duke përfshirë edhe personat mbetjet e të cilëve janë gjetur më pas.
- 77.** Kosova duhet të vendosë një afat kohor për procesin e ndarjes së këtyre dosjeve dhe informacionit.
- 78.** Serbia duhet t'i shmanget politizimit të çështjes së personave të pagjetur.
- 79.** Mekanizmat ndërkombëtarë duhet të mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjes së mundshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në lidhje me zgjidhjen e rasteve të personave të pagjetur.
- 80.** Sanksionet duhet të jenë pjesë e marrëveshjes në rast të mungesës së zbatimit ose zbatimit të pjesshëm.
- 81.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit duhet të shërbejë si mekanizëm i shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të aktiviteteve në llogaritjen e personave të pagjetur.

- 82.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit duhet të angazhojë familjet e personave të pagjetur në Kosovë dhe Serbi në organizimin dhe strukturimin e perkujtimit të personave të pagjetur.
- 83.** Bashkimi Evropian (BE) duhet ta emërojë një të dërguar të posaçëm brenda 12 muajve që do ta trajtonte çështjen e personave të pagjetur mes Kosovës dhe Serbisë, dhe kjo duhet të jetë pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative mes Kosovës dhe Serbisë.
- 84.** Si një alternativë nëse BE heziton të merret me këtë çështje, atëherë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar ose OKB-ja duhet të dërgojnë një të dërguar të posaçëm për t'u marrë me çështjen e personave të pagjetur.

